



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 171/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në përbërje nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhij dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së banerëve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjohë në lartësi prej 1000 (Njëmijë euro), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 05.06.2014 LVV dega në Prizren ka parashtruar ankesë në PZAP me të cilën pretendon se me datën 04.06.2014 aktivistët e LVV-së në Prizren diku rreth orës 14:25 kanë vërejtur se në rrugën "Ismet Jashari - Kumanova" në Prizren, ishte vendosur mbi rrugë publike baneri i Hatim Baxhakut kandidat për deputet nga subjekti politik LDK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe Rregullave Zgjedhore. Parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.06.2014, në ora 17:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK në të cilën deklarohet se posterat e kandidatit në fjalë janë hequr nga vendi ku kanë qenë të vendosura dhe se brenda afatit të paraparë është përmirësuar shkelja dhe si dëshmi për këtë ka bashkangjitur fotografit nga vendi i ngjarjes duke i larguar banerët nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik LDK Hatim Baxhaku është i vendosur mbi rrugët publike ,gjë që e bënë përgjegjëse subjektin politik LDK, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore e që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik LDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se subjekti politik në fjalë ka përsëritur në zgjedhjet e kaluara dhe në këto zgjedhje shkeljen e të njëjtës natyrë, të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik LDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë dhe pas dhënies së urdhërit nga PZAP-i ka ndërrmar masa për evitimin dhe përmasimin e shkeljes së pretenduar në ankesë, siç dëshmohet nga fotografia e ofruar në përgjigje të ankesës. Andaj bazuar në nenin 118.1 dhe në nenin 120 par 1 pika c) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 171/2014 më datën 08.06.2014.

Kryesuesi i Panelit
Erin Osmani


PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*